



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA JURIDIKE E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: "Shërbimi i Printimit, Fotokopjimit dhe Skanimit në Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit"

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 79810000-5 79999100-4

Vlera e Fondit Limit: 2,656,000 lekë pa Tvsh (dy milion e gjashtëqind e psëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 10 (dhjetë ditë) sipas Nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku përcaktohet se "Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës"

Procedura e këtij prokurimi është: Procedure e hapur e thjeshtuar / Kontratë Shërbimi

Kohëzgjatja në muaj: Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të të prokurimit prok publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka

hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin e Ofertë Ekonomike, sipas Shtojcës 1;*

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne të cilën është e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kjo shtojce është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipercituar.

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 9, të Dokumentave Standarte të Tenderit “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se : ” *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”b” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.26, datë 08.09.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Është kërkuar që furnizimet e ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit që është brenda kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar në rregullat e prokurimit publik. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin publik apo privat.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën:

2 (dy) punonjës të cilët duhet të jenë trajnuar/ certifikuar nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar të paisjeve (pika 2.3.2 tabela nr.1-4) të ofertuara në këtë procedurë prokurimi ose nga organe të akredituar kompetente. Në lidhje me këta punonjës të paraqitet edhe çertifikimi përkatës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1 dhe 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, kërkohet, citojmë: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është minimal dhe lejon konkurrimin e hapur për të gjithë operatorët ekonomi të interesuar, duke marrë në konsideratë natyrën, kohëzgjatjen e shërbimit, shtrirjen e tij në territor dhe për faktin se ky shërbim do të kryhet **për të paktën 15 pajisje.**

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor merr në konsideratë, që shërbimi i kërkuar në objekt prokurimi të jetë cilësor dhe i pandërprerë dhe për të arritur një shërbim të tillë, operatori ekonomik duhet të ketë stafi teknik, i cili të jetë trajnuar për teknologjinë e prodhimit të pajisjes që posedon, që të jetë në gjendje të ndërveprojnë në kohë për riparim/ndërrim të pjesëve të dëmtuara dhe të parandaloj defektet potenciale.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje/Printer/Skaner/ Lazer/A4 Me ngjyra	cope	3
2	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/A3 Bardh/zi	cope	2
3	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/A4 Bardh/zi	cope	9
4	Fotokopje/Printer/Skaner Lazer/A3 Me ngjyra	cope	1
	Shuma e pajisjeve	cope	15

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i pajisjeve dhe fatura blerje/ dokumente zhdoganimi /kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruar
- katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet për kryerjen e shërbimit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisje të kerkuara nga autoriteti kontraktor përfitues fundor i këtij shërbimi. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar shërbimin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të shërbimeve, objekt prokurimi

Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "Shërbimi i Printimit, Fotokopjimit dhe Skanimin në Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Njësia e Prokurimit: